



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1490 prot.

Tiranë, më 02. 10. 2019

V E N D I M

Nr. 136, Datë 02. 10. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 29 rregj., datë 01.04.2019, e B. Z., përfaqësuar me prokurë të posaçme¹ nga M. B., kundër Bashkisë Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Tiranë, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në të cilën pretendohet për diskriminim të familjes Z., *për shkak të racës, ngjyrës, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore dhe çdo shkak tjetër.*

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në cilësinë e përfaqësueses ligjore, në mes të tjerash informon se, me vendim nr. 8524, datë 19.10.2018 Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur caktimin e gjyshes E. I., si kujdestare të 3 fëmijëve² të mitur dhe kalimin e përgjegjësisë prindërore babait të tyre B. Z. Përpara dhe gjatë procesit gjyqësor e në vijim, M. B. ka kërkuar menaxhimin dhe trajtimin e rastit të 3 fëmijëve, nga ana e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, për vendosjen e tyre në përkujdesje alternative për shkak të pamundësisë ekonomike të familjes Z. Në kushtet që nga ana e kësaj strukture nuk u ndërmor asnjë masë, atëherë kjo kërkesë iu parashtrua edhe gjykatës gjatë procesit gjyqësor, e cila më datë 18.07.2018 vendosi me anë të një vendimi të ndërmjetëm, që 3 fëmijët e mitur të vendosen në insitucione rezidenciale publike dhe jopublike. Referuar kërkesave të vazhdueshme drejtuar institucioneve si: Bashkia Tiranë, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, prej tyre nuk ka patur asnjë reagim për të monitoruar rastin me problematikat që duheshin zgjidhur dhe për të ndihmuar familjen Z., si p.sh.: sigurimi i një shtëpie; heqjen e përgjegjësisë prindërore të mamasë së fëmijëve E. Th.; sigurimin e një pune të rregullt gjyshes, ku ti paguhen edhe kontributet shoqërore; kalimit pranë një të afërmi (që jeton jashtë vendit) të njërit prej fëmijëve etj.

¹ Nr. Rep., Nr. Kol., datë 24.06.2017

² Shtetasve J. Z., E. Z. dhe O. Z.

Sipas M. B., pavarësisht kërkesave drejtuar institucioneve të sipërcituara, nga ana e tyre nuk ka patur asnjë reagim, duke mosvepruar dhe trajtuar në mënyrë diskriminuese familjen Z. për shkak të racës, ngjyrës, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes shoqërore si dhe çdo shkak tjetër.

Në përfundim, M. B. kërkon nga Komisioneri, trajtimin e ankesës, ndalimin e diskriminimit dhe marrjen e masave administrative ndaj zyrtarëve përkatës të sipërcituara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

1. Për këtë arsye, me anë të e-mailit datë 09.04.2019, strukturat përkatëse të Komisionerit i kërkuan subjektit ankues⁴ të paraqesë shpjegime lidhur me saktësimin e subjektit ndaj të cilit pretendohet situata diskriminuese, si dhe prova dhe fakte për të vërtetuar shkaqet e pretenduara në ankesë.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁴ M. B., në adresën e e-mailit:

- Me anë të e-mailit po në të njëjtën datë 09.04.2019, M. B. ktheu përgjigje por pa dhënë asnjë shpjegim lidhur me kërkesat e Komisionerit për plotësimin e mangësive të ankesës së depozituar.
2. Me anë të shkresës Nr. 507/2 prot., datë 17.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjektit ankues, duke e informuar lidhur me pranimin e ankesës me pretendim diskriminimin për shkak të racës, duke përjashtuar kështu shkaqet e tjera të pretenduara pasi pala ankuese nuk arriti të argumentojë apo provojë shkaqet fillestare të pretenduara.
 3. Me anë të shkresës Nr. 507/1 prot., datë 17.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Bashkisë Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Tiranë, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e palës ankuese.
 - Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës⁵ Nr. 20914/1 prot., Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, sqaruan ndër të tjera se: *“...Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me Punonjësen e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Njesisë Administrative Nr. 3, për tu informuar në lidhje me menaxhimin e rastit të fëmijëve Z. Ky menaxhim ka nisur rreth 2 vjet më parë, pasi gjyshja e fëmijëve, E. I., është paraqitur personalisht pranë zyrave të Njesisë. PMF⁶ 3 ka ndjekur të gjitha hapat për menaxhimin e rastit, në zbatim të Udhëzimit Nr. 10, datë 25.02.2015. Më datë 28.02.2019, në ambientet e Njesisë Nr. 3 është zhvilluar një GTN⁷, me kërkesë dhe këmbëngulje të gjyshes së fëmijëve dhe avokates M. B., ku kanë marrë pjesë PMF 3, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve nga Bashkia Tiranë, TLAS, Psikologia e shkollës si dhe Bashkia Vorë. Në këtë takim nuk morën pjesë, edhe pse e kishin kërkuar që të zhvillohej, gjyshja e fëmijëve bashkë me avokaten e saj. Në detyrat e ndërmarra nga aktorët pjesëmarrës, u vendos që PMF 3 ti kërkonte informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë nëse M. B. ka të drejtë të ushtrojë profesionin e saj si avokate duke qënë se nga kërkimet në QKR rezultoi se e ka të pezulluar aktivitetin si avokate që prej datës 20.06.2018. Duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve, në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve në NJA Nr. 3 ka ndihmuar familjen për rregjistrimin e fëmijëve në arsimin parauniversitar, gjithashtu Bashkia Vorë ka ndihmuar familjen me 100.000 (njëqind mijë lekë të reja), si dhe 27.000 lekë për të 3 fëmijët (si familje kujdestare). Përsa i përket pretendimit të M. B. për diskriminim për shkak të racës, ju bëjmë me dije se në asnjë rast nuk është dalluar, përjashtuar, kufizuar apo shkelur ndonjë e drejtë themelore e ndonjë personi pjesë në procesin e menaxhimit. Përkundrazi të gjithë aktorët pjesëmarrës në këtë proces menaxhimi kanë*

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 507/3 prot., datë 05.06.2019

⁶ Shkurtim i Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve

⁷ Shkurtim i Grupi Teknik Ndërsektorial

patur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve, në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve i është drejtuar me shkresë zyrtare me nr. 17378 prot., Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, për t’i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm”.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës⁸ Nr. 179/1 prot., datë 10.06.2019 Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, sqaroi ndër të tjera se: *“...me cilësinë e autoritetit kompetent për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, kemi kërkuar zyrtarisht në mënyrë të përsëritur nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës vlerësimin dhe menaxhimin e rastit të fëmijëve Z. Në bazë të informacionit të vënë në dispozicion nga këto struktura, M. B. është informuar në mënyrë të vazhdueshme, lidhur me hapat që po ndiqen për menaxhimin e rastit. Rasti i fëmijëve Z., menaxhohet prej 2 vitesh nga Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijës, në Njësinë Administrative Nr. 3, Bashkia Tiranë, bazuar në Ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”. Familja Z. përbëhet nga tre fëmijë E. Z., O. Z. dhe J. Z. Rasti ka filluar të trajtohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës para dy vitesh, me fillimin e procesit gjyqësor të divorcit të prindërve të fëmijëve dhe kërkesës për vendosjen e fëmijëve në një Institucion të Përkujdesit Rezidencial. M. B. ka qënë përfaqësuesja ligjore e babait gjatë procesit gjyqësor të divorcit. Familja Z. sipas Rregjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile rezulton e regjistruar në Bashkinë Vorë, por banon në Njësinë Administrative Nr. 3, Bashkia Tiranë. Në lidhje me këtë familje strukturat në nivel janë ndjekur të gjitha hapat për vlerësimin e rastit dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve, konkretisht:*
 - *Janë realizuar 2 takime të Grupit Teknik Ndërsektorial nga Njësia Administrative Nr. 3 dhe një nga Bashkia Vorë, ku janë ftuar të gjithë përfaqësuesit e institucioneve publike vendore dhe partnerë të shoqërisë civile, të cilët janë identifikuar si të nevojshëm, për të diskutuar dhe adresuar problematikat në lidhje me rastin. Takimi i fundit u realizua në datën 28.02.2019. Edhe pse në takimin ndërsektorial ishte e ftuar M. B. dhe gjyshja e fëmijëve si kujdestarja ligjore e tyre, ato nuk janë paraqitur në takim.*
 - *Në datën 24.07.2018, me Vendim të Ndërmjetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fëmijët janë vendosur në Institucion të Përkujdesit Rezidencial, në Bashkinë Tiranë.*
 - *Me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të tre fëmijët kanë kaluar në kujdestarinë e gjyshes nga ana e babait E. I., pas paraqitjes së kërkesës për kujdestari nga ana e saj.*
 - *Për ti ardhur në ndihmë familjes Bashkia Vorë ka akorduar një fond nga buxheti i tyre në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.*

⁸ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 933/1 prot., datë 12.06.2019

- Të tre fëmijët janë në kujdestari të gjyshes së tyre. Ata përfitojnë nga programet e mbështetjes sociale të familjes. Gjyshja si kujdestare e fëmijëve përfiton pagesën e kujdestarisë, sipas legjislacionit në fuqi. Ajo përfiton një pagesë mujore prej 27.000 lekë, për të tre fëmijët.
- Familja është ndihmuar herë pas here me pako ushqimore.
- Fëmijët janë regjistruar në shkollë dhe kanë ndjekur arsimin parashkollor.

Lidhur me kërkesat e paraqitura nga M. B. për ndarjen e kujdestarisë së të miturve, sqarojmë se bazuar në Ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet bazuar në disa parime shumë të rëndësishme siç janë barazia dhe vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës që është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja parashikohet se “Për të miturit që janë vëllezër e motra caktohet një kujdestar i vetëm, përveç rastit kur rrethanat e veçanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të më shumë se një kujdestari”. Përveç kësaj, M. B. si përfaqësuese ligjore ka ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme në punën e punonjësve për mbrojtjen e fëmijës duke paraqitur kërkesa të vazhdueshme për vendosjen e fëmijëve me masë emergjente në institucionet e përkujdesit rezidencial. Bazuar në legjislacionin në fuqi, vendosja e fëmijëve në institucion vlerësohet si ndërhyrja e fundit nëse nuk ka asnjë alternativë tjetër se ku mund të qëndrojnë fëmijët. M. B. është informuar zyrtarisht nga ASHDMF lidhur me procedurën dhe rastet kur merret masa emergjente e mbrojtjes. Ju bëjmë me dije se rasti është në monitorim të vazhdueshëm nga punonjësja e mbrojtjes së fëmijës në Njësinë Administrative Nr. 3, Bashkia Tiranë, në lidhje me nevojat që mund të kenë fëmijët dhe familja. Përsa më sipër, sqarojmë se menaxhimi i rastit është një proces konfidencial. Detyrimi për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale shtrihet për të gjithë personat dhe institucionet e përfshira në procesin e menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Së fundmi nga kërkimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezulton që M. B. e ka pezulluar aktivitetin e saj si avokate në datën 20.06.2018”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 29, datë 01.04.2019, Komisioneri me shkresën nr. 933 prot., datë 10.06.2019, pasi mori miratimin e palëve në proces, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 21.06.2019.

Në seancë ishin të pranishëm: K. Gj. me detyrë Specialiste në Sektorin e Mbrojtjes dhe Monitorimit, në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës; M. K., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Bashkia Tiranë; R. S., me detyrë Përgjegjës Sektori pranë Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Tiranë dhe E. B., me detyrë Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Bashkia Tiranë, ndërsa pala ankuese u përfaqësua në përfundim të seancës dëgjimore nga Avokate M. B.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullore të Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të rregjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ndaj së cilës është paraqitur ankesa i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës, Specialistja për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njesisë Administrative Nr. 3 (në vijim PMF), informoi KMD-në ndër të tjera se është njohur me rastin e familjes Z. më datë 17.11.2017, më pas ka bërë vlerësimin fillestar dhe atë të plotë të rastit. Pas vlerësimit të plotë, më datë 23.11.2017, nga ana e strukturave përgjegjëse është ngritur Grupi Teknik Ndërsektorial (në vijim GTN), me përfaqësues nga Bashkia Tiranë, Shoqata ARSIS, Shërbimi Social Shtetëror, Bashkia Vorë, Njësia Administrative Nr. 3, si dhe janë thirrur të marrin pjesë i ati i fëmijëve dhe gjyshja e tyre. Nga ana e GTN-së i është ofruar familjes Z., një kontratë qiraje në Njësinë Bashkiake Nr. 3 Tiranë, por është refuzuar nga ana e gjyshes së fëmijëve, për shkak se duke tërhequr gjendjen civile në Njësinë Bashkiake Nr. 3, nga Bashkia Vorë ku ishin të rregjistruar, do t'i duhej të tërhiqnin edhe të ëmën e fëmijëve duke qënë se ishin në të njëjtën certifikatë familjare. Nga ana e PMF-së, sqarohet se fëmijët nuk kanë qënë në kushtet emergjencës, e megjithatë, janë marrë të gjitha masat e mundshme për menaxhimin e rastit, duke ngritur 3 grupe GTN-je, hartuar Plan Individual për secilin nga fëmijët, trajtimin me pako ushqimore dhe veshmbathje, asistimin për rregjistrimin në shkollë dhe në kopësht për secilin fëmijë, asistimin për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e pagesës si familje kujdestare për secilin fëmijë, ndihmë financiare nga ana e Bashkisë Vorë etj. Rasti i fëmijëve Z. është menaxhuar edhe gjatë procesit gjyqësor, sipas PMF-së. Sipas PMF-së, nga ana e M. B. është kërkuar që për një nga fëmijët të caktohet një kujdestar ligjor tjetër, një i afërm i tij që ndodhet jashtë shtetit, por një veprim i tillë nuk është në kompetencat e PMF-së.

Sipas, Specialistes së Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (në vijim ASHDMF), rasti i familjes Z. është menaxhuar me profesionalizëm dhe pa pasur asnjë shkelje të parimit për mbrojtjen nga diskriminimi. Sipas saj, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve është menaxheri i rastit që ka nevojë për mbrojtje. Në këtë kuptim, në grupin e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje bëjnë pjesë të gjithë ata fëmijë që janë: dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar, neglizhuar, fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale që janë të dyshuar për kryerjen e një vepre penale etj. Në rastin konkret, fëmijët e familjes Z., janë fëmijë të cilët janë gjendur përpara një situatë divorci. Pra, sipas ASHDMF-së, nuk janë në kushtet për tu trajtuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës.

Në vijim K. Gj., sqaroi se ASHDMF kujdeset për koordinimin dhe organizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe nuk merret me trajtimin apo menaxhimin e rasteve. Pra nuk ofron shërbime të drejtëpërdrejta për fëmijët. Edhe në rastin në fjalë, ASHDMF ka luajtur rolin e koordinatorit ose përcjellësit të informacionit tek M. B.

Përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë, shtetësja M. K., informoi se jo çdo familje që është në proces divorci mund të trajtohet nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, pasi janë raste specifike ato për të cilat NJMF-ja ka kompetencë për të trajtuar. Gjithashtu, M. K. Shtoi se gjatë periudhës që është trajtuar rasti i familjes Z., nga ana e NJMF-së janë trajtuar edhe 4 raste të tjera të familjeve në proces divorci të cilat i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian. Pra, sipas saj, e parë në këtë këndvështrim nuk jemi përpara një situatë diskriminimi për shkakun e pretenduar nga pala ankuese.

Përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë, shtetasi R. S., shtoi se M. B. është thirrur disa herë për të qënë pjesë e GTN-ve, duke qënë se i ka kërkuar vetë, por nuk ka marrë pjesë në asnjërën prej tyre.

Në përfundim të seancës, M. B. i qëndroi të njëjtave pretendime të paraqitura gjatë trajtimit të ankesës.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, Njësia Administrative Nr. 3 Tiranë, me shkresën⁹ Nr. 1077 prot., datë 03.07.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja.

Në referim të kërkesave të parashtruara gjatë seancës dëgjimore, Njësia Administrative Nr. 3, vuri në dispozicion të KMD-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vizitat periodike të monitorimit në banesë
- Kërkesën e përfaqësueses ligjore të B. Z., drejtuar Avokatit të Popullit dhe kthimin e përgjigjes nga PMF-ja
- Mosfillimin e procedimit penal, lidhur me kallëzimin penal Nr. 8229, datë 27.06.2018
- Komunikimet përmes postës elektronike midis M. B. dhe PMF-së
- Dokumentacion plotësues të menaxhimit të rastit (fletë ditari)
- Raportim Social-Ekonomik drejtuar gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
- Minutat e takimit gjatë takimit të GTN dt. 23.11.2017 dhe Planin Individual
- Minutat e takimit gjatë takimit të GTN dt. 22.06.2018
- Procesverbalin e nënshkruar nga E. I. (gjyshja e fëmijëve)
- Minutat e takimit të GTN dt. 28.02.2019
- Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 8524, dt. 19.10.2019.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A/1. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë, të pretenduar nga ankuesja kundrejtë Bashkisë Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Tiranë.

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1060 prot., datë 04.07.2019.

Nga kqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, shtetasi B. Z. dhe E. Z. kanë qënë të martuar dhe nga martesja e tyre kanë lidur tre fëmijë, shtetasit: J. Z. e datëlindjes 19.07.2009, E. Z., i datëlindjes 24.06.2012 dhe O. Z. i datëlindjes 07.03.2015. Në muajin Korrik 2017, e ëma e fëmijëve është larguar duke i lënë tre fëmijët B. Z. Pas largimit të E. Z., për fëmijët është kujdesur babai i tyre B. Z. dhe E. I. (e ëma e B. Z. dhe njëkohësisht gjyshja e fëmijëve). Në muajin tetor 2017, shtetasi B. Z. ka paraqitur padi civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Zgjidhje martese me shkurorëzim dhe lënien e fëmijëve E. Z. dhe O. Z. në përkujdesje alternative, ndërsa J. Z. nën kujdestarinë e shtetases E. I.”. Gjatë procesit gjyqësor, B. Z., në pamundësi ekonomike për të mbajtur fëmijët ka kërkuar nga gjykata të marrë një vendim për vendosjen e tyre në përkujdesje alternative. Në këto kushte, më datë 18.07.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi me anë të një vendimi të ndërmjetëm, që 3 fëmijët e mitur të vendosen në insitucione rezidenciale publike dhe jopublike për një periudhë të përkohshme. Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Nr. 8524, datë 19.10.2018, është vendosur caktimi i gjyshes E. I., si kujdestare ligjore të 3 fëmijëve¹⁰ të mitur dhe lënien e përgjegjësisë prindërore babait B. Z. dhe të ëmës E. Z. Gjithashtu gjykata vendosi edhe shfyqizimin e masës së përkohshme të vendosjes së fëmijëve në insitucione rezidenciale.

Gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, E. I. është paraqitur pranë Njësisë Administrative Nr. 3, Tiranë, duke kërkuar menaxhimin e rastit të fëmijëve të familjes Z.

Neni 52, i ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” parashikon se: “...2. Grupi teknik ndërsektorial thirret nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në nivel bashkie, ose nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në nivel njësie administrative. 3. Grupi teknik ndërsektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial. 4. Në takimet e grupit teknik ndërsektorial thirren të marrin pjesë: a) anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik; b) prindërit apo anëtarët e familjes ose kujdestarët e fëmijës; c) fëmija, bazuar në moshën dhe në aftësinë e tij për të kuptuar dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij. 5. Grupi teknik ndërsektorial mbështet punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për vlerësimin e rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes¹¹, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes...”.

¹⁰ Shtetasve J. Z., E. Z. dhe O. Z.

¹¹ Refruar VKM, Nr. 578, datë 03.10.2018, parashikohet se Plani Individual i Mbrojtjes është plani me veprime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe parandalimin e cenimit të integritetit të tij, garantimin e të drejtave, mirëqenies, shëndetit dhe zhvillimit të tij, duke mbështetur familjen e fëmijës në realizimin e këtij plani, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës.

Në nenin 5 të VKM-së Nr. 578, datë 03.10.2018 *“Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”*, parashikohen hapat e menaxhimit të rastit, ku citohet se: *“Procesi i menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm: 1. Identifikimin; 2. Raportimin; 3. Vlerësimin fillestar; 4. Vlerësimin e plotë; 5. Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes; 6. Zbatimin, ndjekjen dhe monitorimin e PIM-it; 7. Mbylljen e rastit.”*

Në zbatim të parashikimeve ligjore të sipërcituara dhe kërkesës së bërë nga E. I., më datë 23.11.2017, është mbledhur GTN-ja me përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror, Organizata ARSIS, Komisariati i Policisë Nr. 4, Tiranë, babai i fëmijëve dhe gjyshja nga e ëma. Bazuar në aktet e administruara nga Komisioneri rezulton se, pas takimit nga GTN është hartuar Plani Individual i Mbrojtjes në prani të babait dhe gjyshes nga e ëma, për secilin nga fëmijët, ku janë përcaktuar personat përgjegjës dhe detyrat që duhet të ndjekë secili për menaxhimin e rastit të fëmijëve të familjes Z.

Referuar dokumentacionit¹² të administruar, nga ana e PMF-së është komunikuar në datat:

- 24.11.2017, me anë të telefonit me gjyshen e fëmijëve, E. I., ku i është ofruar pagesa e kontratës së qirasë nga ana e Organizatës ARSIS,
- 28.11.2017, është zhvilluar një vizitë pranë familjes.
- 6, 8 dhe 14 dhjetor 2017 janë kryer vizita në famije dhe tek banesa e gjyshes nga e ëma, ku ndodhej vajza e familjes Z.
- 26.12.2017, nga kontaktet me Komisaratin e Policisë Vorë, evidentohet se B. Z. ka rënë dakord që 3 fëmijët ti mbajë ai.

Referuar dokumentacionit¹³ të administruar, nga ana e palëve në proces, rezulton se mbas GTN-së së mbledhur me datë 27.11.2017, familja Z. është mbështetur me pako ushqimore dhe nga Bashkia Vorë i është dhënë një shumë prej 100.000 lekë të reja. Gjatë trajtimit të rastit pas mbajtjes së GTN-së së parë, rezulton se nga vlerësimi i bërë nuk janë evidentuar shenja të neglizhimit, dhunës etj., për fëmijët Z.

Neni 3, pika 6 e Ligjit Nr. 18/2017 *“Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”*, parashikon se: *“Fëmijë në nevojë për mbrojtje” është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.”* dhe pika 8 e tij parashikon: *“Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.”*

¹² Ditarit të PMF-së

¹³ Minutat e Takimit të GTN-së datë 22.06.2018

Në VKM-në Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, parashikohen qartësisht procedurat e dhe veprimet që duhet të kryehen nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Hapi fillestar për për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje është Identifikimi i rastit, i cili përcaktohet në nenin 6 të VKM-së së sipërcituar, ku citohet se: “1. Identifikimi i një fëmijë në nevojë për mbrojtje bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkerkuesit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët. 2. NJMF-të dhe PMF-të kanë për detyrë të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet planifikimit të punës në terren, verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, që vihet në kontakt me fëmijën, si dhe verifikimit të informacionit për rastet që vijnë në dijeni nëpërmjet medias së shkruar, elektronike apo medias sociale”.

Hapi i dytë i parashikuar nga Neni 7¹⁴, i VKM-së Nr. 578, datë 03.10.2018, është përgjegjësia dhe raportimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Në këtë kuptim, parashikohet se përgjegjësi për raportimin e rasteve e ka çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës të institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit. Çdo mësues, ofrues i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e

¹⁴ 1. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit. 2. Çdo mësues, ofrues i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë njësisë arsimore vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës. 3. Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësin e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës. 4. Profesionistët e përmendur në pikat 1 e 2 të këtij neni, ose struktura përgjegjëse pranë institucionit/ve raportojnë menjëherë, me çdo mjet komunikimi, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje (aneksi nr. 2). 5. Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike apo me postë te punonjësi/njësia përgjegjëse e mbrojtjes së fëmijëve. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi/personat, të cilët janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin. 6. Rasti raportohet te PMF-ja përgjegjëse për territorin ku është bërë identifikimi. Në rast se është e pamundur të kontaktohen këto struktura, njoftohet Agjencia, e cila merr masa për ndjekjen e rastit nga ana e strukturave vendore të mbrojtjes. 7. Me marrjen e raportimit, NJMF-ja/PMF-ja ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit. 8. Procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës, sipas pikës 7, të nenit 67, të ligjit.

fëmijës. Ky raportim mund të bëhet me anë të mjeteve të ndryshme të komunikimit: telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore etj. Strukturat e sipërcituara, kanë detyrimin që identifikojnë rastin nëse paraqet rrezik të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi. Më pas rasti i referohet strukturave përgjegjëse, të cilat janë NJMF-ja dhe PMF-ja, për të trajtuar rastin dhe për të marrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin ose jo të vlerësimit fillestar të rastit.

Më pas, në nenin 8¹⁵ të VKM-së parashikohet procedura që duhet të ndiqet nga NJMF-ja dhe PMF-ja për vlerësimin fillestar të rastit. Vlerësimi fillestar kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit. PMF-ja, gjatë vlerësimit fillestar, analizon: nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, nevojat bazë dhe shërbimet e domosdoshme.

Vlerësimi i plotë është hapi i radhës, parashikuar në nenin 9¹⁶, i cili ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë

¹⁵ 1. Vlerësimi fillestar është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni që mund të merret nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën. 2. Vlerësimi fillestar kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit. 3. PMF-ja, gjatë vlerësimit fillestar, vlerëson: a) Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes; b) Nevojat bazë, për sa u përket ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor; c) Shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuar në kushtet e emergjencës. 4. Vlerësimi fillestar bëhet nga PMF-ja/NJMF-ja në territorin ku gjendet fëmija. Pas intervistimit fillestar të fëmijës apo verifikimit të gjendjes së tij, nëse fëmija nuk është në gjendje të flasë apo të intervistohet, të dhënat e marra nga PMF-ja dokumentohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 orë, në vlerësimin fillestar (aneksi nr. 3). 5. Nëse pas vlerësimit fillestar rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje, atëherë PMF-ja nuk hap dosje, por e referon atë pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm. PMF-ja mban një regjistër të posaçëm për veprimet e kryera për këto raste. 6. Nëse pas vlerësimit fillestar PMF-ja konstaton ekzistencën e rrezikut edhe pasi i ka siguruar fëmijës shërbimet e nevojshme, për shkak të kushteve të emergjencës, ajo hap një dosje specifike (në letër dhe në format elektronik) për fëmijën. 7. Fëmijës i caktohet një numër, i cili do të jetë numri identifikues për të gjatë gjithë procesit të menaxhimit. Ky numër do të përdoret gjatë të gjitha komunikimeve, përveç rastit kur është e nevojshme të përdoret emri i fëmijës, për efekt të referimit apo ndërhyrjeve për mbrojtjen e tij. 8. Drejtuesi i NJMF-së cakton një nga PMF-të e kësaj njësie si menaxher rasti për secilin fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë përkatëse. Drejtuesi i NJMF-së, kur përcakton një PMF si menaxher rasti, merr parasysh ngarkesën e punës të secilës PMF dhe faktin nëse PMF-ja është përfshirë aktivisht në identifikimin apo kontaktin paraprak me fëmijën. 9. Në njësitë administrative ku ka vetëm një PMF, ajo shërben si menaxher rasti për të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje. Në rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në nivel rreziku të lartë ose të menjëhershëm, PMF-ja e njësisë administrative, në menaxhimin e këtyre rasteve, do të mbështetet nga PMF-ja e bashkisë, i cila do të caktohet nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki.

¹⁶ 1. Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes. 2. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë, vlerëson: a) Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut; b) Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj dhe nevojat e familjes; c) Faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë; ç) Në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, vlerësimi përfshin edhe rezultatin e procesit të konfirmimit të masës nga gjykata, vlerësimin e kushteve të institucionit, të personit apo familjes kujdestare pranë të cilit është vendosur fëmija, në kuadër të masës. 3. Për realizimin e vlerësimit të plotë, PMF-ja duhet të kryejë, të paktën: a) Një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë vizitës

informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë, analizon: Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut; Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj dhe nevojat e familjes; Faktorët mbrojtës, në veçanti pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, të familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë; Në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, vlerësimi përfshin edhe rezultatin e procesit të konfirmimit të masës nga gjykata, vlerësimin e kushteve të institucionit, të personit apo familjes kujdestare pranë të cilit është vendosur fëmija, në kuadër të masës. Për realizimin e vlerësimit të plotë, PMF-ja duhet të kryejë, të paktën: Një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë vizitës i hedh në formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime; Një intervistë me fëmijën, motrat/ vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, siç tregohet në formularin e intervistimit.

Pas mbledhjes së informacioneve për rastin, PMF-ja plotëson formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut. Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe PMFja ka detyrimin të mbledhë GTN-në, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë. Në rastet e rrezikut të ulët, PMF-ja mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson të nevojshme. Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve, nga miratimi i masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit të shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

Në nenin 10, 11 dhe 12 të VKM-së parashikohet Hartimi i Planit Individual, Zbatimi, monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it dhe Monitorimi i PMF-i për zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes. Në to parashikohen qartësisht, veprimet dhe institucionet përgjegjëse për ndjekjen në vijimësi të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje deri në momentin që shihet që fëmija ka patur ose jo progres pas zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes.

Nga provat e administruara rezulton se M. B., i është drejtuar me e-mail datë 12.06.2018, Njësisë Administrative Nr. 3 Tiranë, duke pretenduar se nga ana e PMF-së, nuk është thirrur GTN-ja dhe nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për trajtimin dhe menaxhimin e fëmijëve të familjes Z. Në përgjigje të kërkesës së M. B., nga ana e PMF-së së Njësisë Administrative Nr. 3, i është kthyer përgjigje duke i sqaruar ndër të tjera se: “...1. bazuar në ligjin 18/2017 ‘Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve’, neni 52, pika 2, GTN thirret nga

i hedh në formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime (aneksi nr. 4); b) Një intervistë me fëmijën, motrat/ vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, siç tregohet në formularin e intervistimit (aneksi nr. 5). 4. Për realizimin e vizitave në familje, në rastet kur është e nevojshme për arsye sigurie apo kur prindi nuk është bashkëpunues dhe nuk lejon vizitën apo takimin e PMF-së me fëmijën/fëmijët e tjerë të familjes, PMF-ja kërkon që gjatë kryerjes së vizitës në familje të shoqërohet nga strukturat e Policisë së Shtetit. 5. Pas mbledhjes së informacioneve për rastin, PMF-ja plotëson formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut (aneksi nr. 6). 6. Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe PMFja ka detyrimin të mbledhë GTN-në, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë. Në rastet e rrezikut të ulët, PMF-ja mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson të nevojshme. 7. Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve, nga miratimi i masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit të shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

drejtori i strukturës përgjegjësepër shërbimet shoqërore në nivel bashkie, ose nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel njësie administrative. Përsa më sipër, PMF duhet të thërrasë GTN-në pas vlerësimit që i bën rastit dhe nevojave që evidenton. 2. Fëmijët nuk janë evidentuar në asnjë nga kushtet e parashikuara nga nenet 53, 54 dhe 55 të ligjit 18/2017. Nëse fëmijët do të ishin gjendur në kushte neglizhimi të konfirmuar, të abuzuar apo të neglizhuar, si dhe pa kujdes prindëror, PMF-ja do të kishte marrë masa të menjëhershme brenda kompetencave të Njësisë Administrative Nr. 3 dhe Bashkia Tiranë, më saktësisht: Ndjekje e procedurave në komisarjat (nëse fëmijët do ishin braktisur apo çdo situatë tjetër që nuk respektohet interesi më i lartë i fëmijëve). GTN-ja i mbajtur në Njësinë Administrative Nr. 3, i ka ofruar pako ushqimore dhe pagesën për të lidhur kontratën e qirasë, në mënyrë që kjo familje të marrë shërbimet përkatëse pranë Njësisë Administrative Nr. 3.”

Përsa më lart, më datë 22.06.2018, është mbledhur GTN-ja e radhës, ku ka marrë pjesë si përfaqësuese e familjes Z., M. B. Referuar dokumentacionit¹⁷ të administruar, nga ana e palëve në proces, rezulton se më datë 20.06.2018, pas përgjigjes së dhënë nga ana e PMF-së me anë të e-mailit, M. B., ka shoqëruar 3 fëmijët në komisarjat dhe është asistuar nga PMF-ja. Më pas është paraqitur E. I. dhe babai i fëmijëve, i cili ka deklaruar se për shkak të gjendjes ekonomike nuk mund t'i mbajë fëmijët dhe të kujdeset për ta. Në këtë kuptim fëmijët janë konsideruar të braktisur, pasi asnjë nga familjarët nuk ka dashur t'i mbajë. Përpara kësaj situatë PMF-ja ka shoqëruar fëmijët për në qendrën e emergjencave ARSIS. Në përfundim të takimit të GTN-së, është konkluduar që fëmijëve t'u jepet masë emergjente mbrojtje nga NJMF dhe Bashkia Vorë. Pas kërkesës së palës ankuese, më datë 18.07.2019 gjykata ka vendosur që 3 fëmijët të kalojnë në institucione rezidenciale publike dhe jo publike.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Nr. 8524, datë 19.10.2018, me kërkesë të gjyshes E. I. është vendosur caktimi i saj, si kujdestare ligjore të 3 fëmijëve¹⁸ të mitur dhe lënien e përgjegjësisë prindërore babait B. Z. dhe të ëmës E. Z. Gjithashtu gjykata vendosi edhe shfyqizimin e masës së përkohshme të vendosjes së fëmijëve në insitucione rezidenciale.

Pasi gjykata është shprehur me vendimin e mësipërm për caktimin e kujdestarisë së fëmijëve E. I., më datë 19.12.2018, M. B. i është drejtuar sërish me e-mail Njësisë Administrative Nr. 3 Tiranë, duke njoftuar se gjendja ekonomike e kujdestares së fëmijëve është e rënduar dhe në këto kushte ka kërkuar të ndihmohet nga kjo njësi me ndonjë ndihmë financiare, pako ushqimore apo pagesë qiraje. Në përfundim ka kërkuar nga Njësia Administrative Nr. 3, mbledhjen e GTN-së për të shqyrtuar rastin dhe fuqizuar ekonomikisht kujdestaren e fëmijëve Z.

Më datë 27.12.2018, nga ana e PMF-së, i është kthyer përgjigje M. B. me anë të e-mailit, duke i sqaruar se: “...të tre fëmijët janë sistemuar dhe frekuentojnë arsimin parauniversitar. Gjithashtu përfituesja e kujdestarisë (gjyshja) së tre fëmijëve është adresuar dhe asistuar për plotësimin e dokumentacionit pranë Bashkisë Vorë ku ka kryer aplikimin për të përfutur ndihmën ekonomike në kategorinë e fëmijëve në shërbim kujdestarie, përkatësisht 9000 lekë të

¹⁷ Minutat e Takimit të GTN-së datë 22.06.2018

¹⁸ Shtetasve J. Z., E. Z. dhe O. Z.

reja në muaj për çdo fëmijë, në bazë të legjislacionit të ndihmës ekonomike. Përgjatë kësaj periudhe kohore familja është ndihmuar sistematikisht me pako ushqimore.”

Më datë 09.01.2019, M. B. i është drejtuar sërish me e-mail PMF-së, duke kërkuar që: “Referuar rastit Z. ju duhet patjetër të mblidhni një grup teknik për të shqyrtuar apo monitoruar me aktorët e tjerë progresin e rastit në menaxhim sipas **një Plani Individual referuar neneve 51 dhe 52 të Ligjit ‘Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve’ Nr. 18/2017 në lidhje me masën e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar. 1) Nëna kujdestarja e tyre e ka shumë të vështirë të mbajë të tre fëmijët dhe djalin e madh do ti duhet dhe mund tia lërë në kujdestari ndonjë kushëriri të saj (për këtë të nisin procedurat nga NJMF si organ proçedues i fëmijëve). 2) PMF -ja duhet të heq në prokurori përgjegjësinë prindërore nënës me vendim gjykatë pasi i ka braktisur dhe për një kohë të gjatë nuk interesohet për ta. Një çështje e tillë është hapur me anë të një kallëzim penal në komisariat nga babai i fëmijëve por u pushua pasi zhvillohej në të njëjtën kohë me çështjen civile të divorcit. Në pritje të ftesës së mbledhjes së grupit multidisiplinar për të hartuar planin në kohën e monitorimit dhe diskutimit të problematikave të lartëpërmendura . 3) Ndërkohë që duhen marrë masa për të fuqizuar edhe babain i cili është i papunë në mënyrë që për fëmijët të kujdeset ai. Dihet që për të fuqizuar një familje nuk mjaftojnë pakot ushqimore. Shkollimi, përfitimi i kujdestarisë janë gjërat bazike dhe më minimale në sistemin e fëmijëve që rrjedhin pas zbatimit të vendimit të gjykatës”.**

Në përgjigje të emailit të sipërcituar, PMF-ja më datë 10.01.2019, ka informuar M. B. se: “Lidhur me rastin Z. unë PMF e Njesisë 3, nuk kam propozuar asnjë masë lidhur me vendosjen e fëmijëve në mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar Neni 58 i Ligjit Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve". Kjo masë propozohet vetëm nga Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe firmoset nga Drejtori i Shërbimeve Sociale jo nga gjykata. Fëmijët Z. janë vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, nën kujdestarinë e një të afërmi përkatësisht gjyshes nga babai, e cila ka përmbushur kriteret për të qënë kujdestare ligjore e fëmijëve Z.. Pas vendimit të gjykatës janë marrë masa: Përfituesja e kujdestarisë (gjyshja) së tre fëmijëve është adresuar dhe asistuar për plotësimin e dokumentacionit pranë Bashkisë Vorë. I është reduktuar pagesa për fëmijën O. Z. që është në Kopësht nga Janari. Grupi teknik ndërsektorial M. B. mblidhet ku fëmija/fëmijët janë në rrezik. Dhe këta fëmijë nuk janë në rrezikshmëri, niveli i rrezikut është i ulët për të mos thënë që nuk ka rrezikshmëri fare. Kujdestarja po drejtohet drejt institucioneve përkatëse, është ndihmuar me pako dhe përfitimet që ka nga kujdestaria e tre fëmijëve.”

Neni 58, i Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, lidhur me masën e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, parashikon se: “1. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës. 2. Kjo masë vendoset edhe në rastet kur fëmija mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësitë dhe mundësitë për t’u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, i cili dyshohet ose provohet se ka abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën dhe i cili nuk banon apo i cili, për shkak të një

urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhri mbrojtjeje nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje. 3. Plani Individual i Mbrojtjes, i cili përmban edhe masën e mbrojtjes së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, hartohet në bashkëpunim me prindërit ose njërin nga prindërit. Në rast se prindërit nuk bashkëpunojnë apo nuk japin miratimin e tyre për ndjekjen e fëmijës me këtë masë mbrojtjeje, atëherë strukturat e mbrojtjes së fëmijës vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes.”

Gjithashtu në të njëjtën frymë me Ligjin Nr. 18/2017, është edhe neni 20 i VKM-së Nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, i cili parashikon se: “1. Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar vendoset për fëmijën, i cili: a) Ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes; b) Mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësinë dhe mundësitë për t’u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, që dyshohet ose provohet se e ka dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën. Prindi nuk banon apo, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo urdhri mbrojtjeje, nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje; c) Dyshohet ose ka kryer veprë penale dhe është nën moshën e përgjegjësisë penale. 2. PMF-ja, në çdo rast, vlerëson nëse rrethanat e lejojnë që fëmija të trajtohet dhe të mbrohet pranë familjes.”

Përsa më lart dhe në referim të informacionit të shkëmbyer nga ana e palëve, rezulton se kompetencën për të vlerësuar nëse fëmijët e familjes Z. kanë qënë në kushtet përfitimit të masës së mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, e ka PMF-ja, që në rastin konkret ka vlerësuar se nuk janë në kushtet përfitimit të masës së mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar.

Në vijim të komunikimeve me e-mail dhe kërkesave të sipërcituara të M. B., PMF-ja e Njesisë Administrative Nr. 3 Tiranë, me anë të e-mailit, datë 22.02.2019, i është drejtuar M. B., duke e ftuar në takim në ndërsektorial më datë 28.02.2019, në ambjentet e Njesisë Administrative Nr. 3 Tiranë.

Sipas njoftimeve të realizuara më datë 28.02.2019 dhe kërkesave të M. B., është mbajtur GTN-ja me përfaqësues nga:

- Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Tiranë
- Shërbimi Ligjor TLAS
- Shkolla 9-vjeçare “Hasan Prishtina”, (punonjësja psikosociale)
- Shërbimi Social, Njësia Administrative Nr. 3
- Bashkia Vorë, PMF-ja
- Organizata ARSIS
- Bashkia Vorë, Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve

Gjatë takimit të GTN-së, evidentohet se nuk kanë qënë prezent asnjë nga përfaqësuesit e familjes Z. Megjithatë, takimi ka vijuar ku janë diskutuar edhe një herë problematikat e ngritura nga ana e M. B. Ndër të tjera në takimin e mbajtur është referuar se: “...*Sipas shkresave drejtuar Bashkisë Vorë, M. B. kërkon vendosjen e fëmijëve me masë emergjente në institucion të përkujdesjes. Sipas ligjit të Mrojtjes së Fëmijëve Nr. 18/2017, propozimin për masë emergjente e ndërmerr Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve në bazë të kuadrit ligjor. Theksojmë se nga vlerësimet asnjëherë këta fëmijë nuk janë ndodhur në kushtet për masë emergjente...Sot gjyshja e fëmijëve, ka kërkesa që njërin nga fëmijët, konkretisht E. Z. ta dërgojë në Itali pranë një të afërmi dhe të ndihmohet me strehim. Nga vlerësimet e realizuara për këtë familje ka konkluduar që kjo familje ka kushte normale, paguan qiranë 17.000 lekë. Merr 27.000 lekë për të tre fëmijët dhe sipas deklarimeve të E. I. e ndihmon edhe bashkëshorti nga Maqedonia. E. I. ka qënë në punë dhe është ndihmuar edhe nga institucione shtetërore dhe organizata.*”

Në analizë të informacionit të sipërcituar rezulton se nga ana e PMF-së, Njësisë Administrative Nr. 3 Tiranë, është ndjekur në vijimësi rasti i fëmijëve të familjes Z., duke kryer edhe vizita të herëpashershme në banesën e tyre në datat:

- 24.12.2018, ku PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitën në shtëpi dhe nuk kanë evidentuar asnjë problematikë. Në përfundim E. I. është njoftuar për tërheqjen e një pakoje ushqimore pranë Njësisë.
- 07.01.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitë në shtëpinë e E. I., në kopshtin e fëmijës së vogël dhe në shkollën e fëmijëve më të rritur. Gjatë vizitave është parë se fëmijët janë integruar dhe nuk kanë shfaqur asnjë problematikë.
- 04.02.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitën në shtëpi dhe nuk kanë evidentuar asnjë problematikë.
- 18.02.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitën në shtëpinë e E. I., e cila ka kërkuar që një nga fëmijët ta dërgojë tek një i afërm jashtë shtetit. Nga ana e PMF-së i është bërë me dije se nuk janë kompetencë e tyre për shqyrtimin e kësaj kërkesë.
- 04.03.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitën në shtëpi dhe nuk kanë evidentuar asnjë problematikë.
- 20.03.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitë në shtëpinë e E. I., por fëmijët kanë qënë në shkollë. Në këto kushte kanë komunikuar me drejtuesit arsimor dhe nuk janë raportuar shqetësime.
- 18.04.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitë në shtëpinë e E. I., e cila ka kërkuar prej tyre banesë sociale ose shtëpi me qera dhe nuk është e kënaqur vetëm me pako ushqimore. Nga komunikimi me fëmijët nuk janë shfaqur problematika.
- 17.05.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitë në shtëpinë e E. I., e cila ka kërkuar prej tyre banesë sociale ose shtëpi me qera dhe nuk

është e kënaqur vetëm me pako ushqimore. Ndërkohë rasti është nbyllur nga GTN. Nga komunikimi me fëmijët nuk janë shfaqur problematika.

- 13.06.2019, PMF-ja së bashku me Administratoren Shoqërore, kanë kryer vizitën në shtëpi dhe nuk kanë evidentuar asnjë problematikë të shfaqur nga fëmijët.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjitha institucionet.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁹. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në ky Ligj, ka parashikuar në nenin 7/1: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Nga analiza legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, evidentohet se nga ana e Bashkisë Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, Njësia Bashkiake Nr. 3, Tiranë, janë ndjekur të gjithë hapat e parashikuar për trajtimin e rastit të fëmijëve të familjes Z. Në këto kushte, në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e subjekteve të sipërcituara, për shkakun e pretenduar.

A/2. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë, të pretenduar nga ankuesja kundrejtë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Neni 41, i Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, ku specifikohen detyrat e e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në lidhje me ngritjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, parashikon se: “Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. 2. Agjencia ka për detyrë t’u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me: a)

¹⁹ Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

koordinimin me agjenci të tjera shtetërore dhe private; b) zhvillimin e aktiviteteve profesionale, në lidhje me mbrojtjen e fëmijës; c) asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të caktuara të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe supervizionin, në raste të caktuara; bashkërendim të punës për raste ndërshtetërore të mbrojtjes së fëmijës; ç) këshillimin e agjencive shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të punonjësve që punojnë në institucione publike e private për ndihmën e fëmijës në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, për të cilën agjencia nxjerr një urdhër të brendshëm për mënyrën e funksionimit. 3. Agjencia ka për detyrë gjithashtu: a) të mbledhë të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe të menaxhojë regjistrin elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje; b) të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë të parandalimi; c) të kontrollojë cilësinë e shërbimit të strukturave të mbrojtjes; ç) të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje; d) në zbatim të nenit 11, pika 6, e këtij ligji, të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për realizimin e procesit të mbrojtjes dhe marrjes së masave për menaxhimin e rasteve të fëmijës në situatë migrimi, në situatë ndërkuftare dhe në nevojë për mbrojtje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të fëmijës së pashoqëruar.”

Referuar provave të administruara, në cilësinë e autoritetit kompetent për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, ASHDMF ka kërkuar zyrtarisht nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës vlerësimin dhe menaxhimin e rastit të fëmijëve Z. Gjithashtu, në bazë të informacionit të vënë në dispozicion, ASHDMF-ja ka vlerësuar dhe analizuar punën e kryer nga strukturat e Njësisë për Mbrojtjen në Fëmijëve lidhur me trajtimin e rastit të fëmijëve të familjes Z., për të cilat M. B. është informuar në mënyrë të vazhdueshme, lidhur me hapat që janë ndjekur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri nuk arriti të sigurojë prova se ndaj anëtarëve të familjes Z. janë ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë, ose që i ka ekspozuar ata, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me ta, nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Tiranë, Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Tiranë, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankesues.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të familjes Z. nga ana e Bashkisë Tiranë, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Nr. 3, Tiranë, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për shkak të racës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)